



Libri "Nënqeshja e ëmbël" 2001



Vera Istrefi

* * *

Në vend të parathënies

"E fshehta përvëluese" e një poezie

Gjithmonë më ka ngacmuar ideja se krijimi poetik vjen në ndërgjegjen e krijuesit befas, pa ndonjë imponim. Kur ndodh kështu, poezia gjithëherë është emocionale, e thellë, shpirtërore. Zakonisht poezia vjen vetë. Poezia e vërtetë nuk njih korniza,

ndryshe ajo sëmuret nga skematimi. Kur çlirohet krijimi, vlerat e tij janë krejt të veçanta. Në këto kushte poezia i këput vargojt dhe del ashtu siç është, e përkryer, pa patur nevojë të lëmohet.

E kësaj natyre është edhe poezia e Vera Istrefit. Ajo pas vëllimit të parë "Shiu i fundit", del si profil artistik më vete. Poezinë Vera e shkruan për vete. Ky është parimi i saj. E ngacmuar nga realiteti, kundrejt të cilit ajo është shumë e vëmendshme, mbledh gjithçka i bën përshtypje dhe pastaj gjykon në mënyrën e saj, në stilin e saj, me mjetet e saj artistike. Në poezi ajo pasqyron veten, shqetësimet, emocionin, trishtimin, krenarinë, ngritjen e gëzimet e shpirtit, vetminë, përçmimin, dashurinë, rrjedhjen e kohës etj.

Ndjen trokëllimën e takave të veta në trotuar dhe i bën përshtypje, por vëren edhe shikimin e një të panjohuri, sytë e të cilit nuk dinë se ç'kërkojnë. Në darkë shtrëngon në gji djalin dhe ndjehet e lumtur, siç e ndjen veten të trishtuar pse kaloi një çerek shekulli i jetës se saj kaq shpejt dhe ka droje se mos po e flakin "ndane rrugës si mollë e kafshuar". Poezia e Verës është mister, për nga ideja, solide për nga ndërtimi dhe koncize strukturalisht. Kjo është teknika poetike e saj. Krijimeve nuk u ve titull. Kështu e ka zgjedhur ajo. Por kjo praktikë i ka dhënë mundësinë për të ndërtuar vëllimin si një lëndë e vetme. Poezitë pasojnë njëra tjetrën dhe idetë duket sikur lihen përgjysëm në njerin krijim, e vazhdojnë në tjetrin, e kështu deri në fund. Unë gjykoj se ideja e saj i ka rritur vlerat artistike.

Vëllimi "Nënqeshje e embël" është pa dyshim arritje e Vera Istrefit. Ajo në ndryshim nga vëllimi i parë poezinë e ka më të plotë, si nga idetë, ashtu edhe nga mjetet artistike që përdor. Kjo dëshmon për pjekurinë e saj dhe përpjekjet për të qenë individualitet artistik. Shpesh poetja shprehet "nëse dikujt i pëlqen poezia ime le ta lexojë". Thënie modeste, por realisht kjo poezi jo vetëm lexohet, por edhe lë mbresa, veçmas në botën femrore.

Besim R Cengu

* * *

1

*Thana
Epara çel,
E fundit piqet.
Gjatë i gëzohet lulëzimit,
Për t'ju shmangur vjeljes.
Vetë,
U poqa pa lulëzuar,
Askush s'kujtohet,
thanën ta shartojë.
Bryma ma zë frymën,
Ndërsa thana,
ende në pjekje.*

2

*E nis udhëtimin
Për në fund të vetes time,
Duke mbartur edhe mendimin
e të tjerëve
Gjatë udhëtimit,
Marr shumë vendime
Për falje,
Miqësira
Dashuri
Asnjë për ligësi...
S'dua të dal nga vetvetja.*

3

*Sodis me nge,
Trajatat e hijeve të njerëzve,
Pa patur frikë se më urrejnë,
Vetëm pse i shoh.*

*U vesh atyre tipare paqësore,
Deri në lodhje.
Nuk i sodis dot,
Zotërit e tyre.*

4

*Copëra akujsh,
Notojnë në sytë tuaj.
Detërat tradhëtie,
Ç'duan të bëjnë me mua?!!
Ngrohtësia e shqetësimit tim
Mundohet ti shkrijë.
Tym e pafajësi
Më kanë pushtuar.
Përpiqem të gjej një mënyrë
Akujt t'i shkrij.*

5

*Kam zënë përkrahu
Trishtimin,
Të shkoj të takoj harresën.
E në vend që të arrij qëllimin tim,
Kur bëhemi tre,
Zihemi.
Largohem...
Sakaq sherri pushon,
E ata më ndjekin pas.*

6

*Eci
Po, po, eci.
Më është mpiksur truri
në një mendim.
Por fryn erë,
që, ndonëse s'më ndryshon drejtim,*

më shtyn.

Eci

Kam një mall të pasosur,

S'di për çfarë,

Që zgjat duart

E më shtrëngon

Trurin ma shtrydh

7

Nënqeshja e ëmbël

E pranverës,

Fatkeqësi për mua,

Që shetit nga zërat e njerëzve,

Në ajrin që thithin

Mushkëritë e mia.

Natyral më fal

Endje e ngazëllim.

E dielli, vetëm përcëllim.

8

Në mbrëmje shihja

Njerëz,

Hije.

Gjithçka më dukej

Se në tokë ishte konturuar

Me të njejtën formë!!

Ç'përfytyrim!!

Ndoshta pse njerëzit,

E hijet e tyre,

S'bëjnë dot paqe.

9

Bisedoj me miq e armiq,

të njohur e të panjohur.

Ndjej shikimin e tyre,

*që synon
zbulimin e sekretit tim.
Duke respektuar
Të gjithë në dukje,
mendoj veç për veten*

10

*Mbi tiparet e bukura
të fytyrës time
shoh lodhjen e kohës,
Me lapsat e trashë,
konturoj tiparet.
Njerëz,
ka diçka të thjeshtë,
pa zbukurime,
Mbi çdo llustër e lavdërim,
përbri artit tim,
qëndron shpirti
i destinuar për flijim.*

11

*Eci në rrugë lirshëm,
me barkun sa një kosh,
dhe e ndjej se jeta,
me lodron në gjoks.
Era më përkëdhel
dhe vështrimet e kalimtarëve
i përulan.
Nën fustanin e lehtë,
hidhet e lëvrin,
e s'do tia dijë për asgjë
bebi im.*

12

Ti, i panjohur

*që ec në trotuar,
krah meje,
duhet të jesh i shurdhër,
ose shtiran,
në shpirtin tim prej femre.*

13

*Më ka ikur qetësia
e jetës
si gruaja tradhëtare
bashkëshortit shtratit.
Nuk lodhem ta qas përsëri
Ajo s'do të më vijë...*

14

*Më pret,
më pret papushim,
edhe kur jeta
fytyrën ma mbulon me trishtim.
Kur mbi mua shkëlqen pranvera,
më prët.
Zhytem në gjirin e tij,
Dhe hesht.
Kështu ndjell gjumin,
e zgjohem të nesërmen,
pa i dhënë shpjegim.
Ai më buzëqesh,
sikur me thotë,
“tërë jeten të pres”.*

15

*Shumë e trazoj veten.
Asgjë nuk shpresoj prej ndokujt,
tek shëtis në rrugën time.
Nuk hedh shikime me pahir,*

*as përfytyroj.
E shten goj vetminë,
jo si grua,
por si njeri.*

16

*Po me ikin ëndërrimet
e lindura në kaq vite,
të reja,
të bukura si më parë.
Nuk zgjas dorën t'i ndaloj.
Nga ato,
Ç'munda në jetë,
kam marrë*

17

*Mbi tavolinën që lëkundet,
nën mbulesë të vjetër,
ku njolla të çuditshme duken,
gota e krisur tundet,
nën një valle të panjohur.
Mbi të, asgjë tjetër.*

*Për inat të kësaj tavoline,
sot mbi te , veç gotës,
që në vend të ujit,
formë u ka dhënë
mendimeve të mia...
Krisur zemra ime*

18

*Një lumë rrjedh,
brenda e jashtë meje.
Lumi rrjedh,
e më imponon ritmin e tij*

19

*Heshtje,
vetëm heshtje.
tek thur trikon e djalit,
e shtizat nëpër duar
kryqëzohen
Thur trikon
me vija të bardha,
jeshile.
Njëkohësisht,
thur jetën time.*

20

*Çdo ditë e më tepër
mendimet më turbullohen.
Kam lindur mes dhimbjesh
si të gjithë.
Turbullimet e reja
do të qetësohen,
Ndërsa përpiqem të largoj,
frikën e tradhëtisë.*

21

*Hapa
të lehtë
të rëndë
në shetitoren tonë.
S'po mundem t'i duroj dot.
Jeta po më shkon,
nën trokëllimat
e ritmin e këtyre hapave
jo të sigurtë*

22

*Është ftohtë në dhomë,
sidomos tani,
që u shuan dritat.
Tërheq tim bir
drejt kraharorit,
dhe hesht.
Pak ngrohtësi,
shkëmbejmë me njëri-tjetrin.
E zhys thesarin brenda vetes
dhe ndjem e lumtur,
ndonëse kam të ngjethura.*

23

*Natyrshëm,
kam hedhur mbi trup
pallton e vjetër.
E ndjej veten mirë.
Gjithsesi,
s'jam e zhveshur...*

24

*Ligësitë,
në këtë çoshkë të gjithësisë,
ndihem mbretereshat e mia.
Unë mbetem
e stërlodhur pamëshirshëm,
duke iu bindur urdhërave të tyre.
Në çoshkun e zemrave njerëzore,
ndihem mbretëreshë e vetme
vetëm unë.*

*Jam dafinë
zhveshur nga gjethet.
Mbi kokë,
kurorë mekatesh mbart.*

25

*Jam Doruntinë zemërplasur,
e vetme pranë portës,
në anë të së cilës,
janë engjejt e djajtë.
Pres një Kostandin,
me vete të më marrë.*

26

*Viktive e mblesërve,
Hedh këmbën zvarrë në rrugë,
Në dukje pa zhurmë.
Por...
Mua më shurdhon,
Kjo zvarritje dhimbjeje,
Tek përfytyroj,
Gjestet e saj prej maturanteje.*

27

*Rrethuar jemi
Me pritje...
Një muaj.
Ca më shumë,
E ca më pak.
Nuk i dihet...
Ti përkedhel djalin
E unë ndjej lëvizjet e tjetrit
në trupin tim.
Presim një mori hallesh më shumë.*

28

*Tetori po vjen,
Si çdo vit
Me erëra,*

*Re,
Vaktësi.*

*Jo, jo,
Si ndër vite,
Por disi më ndryshe.
Koha rrjedh...
Rreshqet,
Përmbi te,
Mendimet e mia,
Nën këmbë,
Vitet e jetes shkilen,
Në pritje të bëhen
Njëzet e pesë.*

29

*E sjell unazën e florinjte,
Rreth gishtit tim delikat,
Shpejt,
Ngadalë.
Asgjë tjetër,
S'mund të bej,
Tek dëgjoj biseda monotone,
E gjykime pa vlerë,
Të grave të papuna.*

30

*Më vuan shpirti
Për një buzëqeshje,
Për një fjalë të sertë.
Shpirti im
S'njuh përulje për mbret.
Vrapon,
E vrapin se ndal,
Gjer një pafundësi,
Dikujt një buzëqeshje,*

*A një fjalë të sertë
T'i fale...*

31

*Nuk me ikin netët,
Pa marrë me vete,
Pjesë të nervozizmit tim,
E mbresat e ditës së djeshme.
Përnatë
Lakoj dëshpërimin,
Duke e kaluar,
Nga unë
Tek ti,
E në fund,
Tek ai.
Të nesërmen,
Përsëri zgjohem me dëshpërim...
U bëj vend shqetësimeve të reja*

32

*Kokëfortësia
E flokëve të mi atë pabindura,
I bën balle forcës trishtuese,
Të krehërit e vajit të bajames.
Nga koka ime e gjelbërt,
Me pak se njëçerekshekullore,
Asnjë mendim s'pasqyrohet,
Veç atyre,
Nga të cilat kam frikë.
Nesër,
Në treg do të blej një rrjetë,
T'i mbledh mirë,
Flokët e pa bindura.*

33

*Instiktivisht,
Kruaj dhëmbët kur flet ti,
E mendimet përqëndrohen,
Në një pikë të errët,
Të bisedës tënde që vetëm nxin.
Ndërsa mundohesh,
Të fshehësh me fjalë të bukura,
E buzëqeshje pa shkak.
Ndjeva
Se nga mishi i dhëmbëve,
Po rridhte gjak.
Ç'ti bësh!
Përsëri mbeti pika e errët,
E ti qetësisht heshtje,
Duke menduar,
Se ia dole mbanë.*

34

*Një vjeshtë jo e zakonhtë,
Ka ardhur brenda meje,
Jo nga zbehtësia,
A nga vyshkja,
Por nga trishtimi.
I shkel gjethet e blirit,
Dhe vetëm hesht.*

35

*Prapë nuk po vjen!
Më kot kam pritur,
Kaq vite.
S'di në ç'portë të trokas.
Sikur të takohemi,
Qoftë edhe një herë,
Mbase nata për mua,
Terr s'do të kishte,*

*As dielli perëndim.
Mos ma kurse këtë ndjesi,
Torturuesja-poezi*

36

*Po ngryset vetmia ime,
ka pushtuar kodrën.
Rrafshësia e liqenit,
Shkëmbinjtë,
Shkurret,
Zaptojnë shikimin.
Horizont i murrmë,
Monoton.
Yjet shpojnë qiellin,
Në rrugë
fllenë ndjenjat,
E udhëtarëve të lodhur.*

37

*Me fijen e hequr të qorapit,
Veten kam ndjerë pështirosur.
Më është çiflosur shpirti.
Në të vetmin rast,
Zvarrë tërhoqa kohën.
Për të mos më ikur,
Qoftë një fije tjetër,
Me sapun kam ngrirë,
Pjesë të qorapit të vjetër.*

38

*Më lini,
Të digjem në hallet e mia.
Kam zjarrë brenda vetes,
Për të shkrirë akujt
Mes nesh.*

*Ma lini jetën me halle
Veç mua,
S'po kërkoj gjë hua.
Mos ma shkelmoni shpirtin,
Se vetëm ai më ka mbetur.
Lermani lotin,
Të më rrjedhë hijshëm,
Poshtë syve.*

39

*Me thuaj diçka...
E pakuptueshme,
E ftohtë.
Mendova me vete;
“Statujë ngurtësuar
më ka djallëzia jote...”*

40

*E di
Se edhe këtë dimër,
Debora do të bjerë,
Mbi dhembjet e mia.
E unë,
Gjithnjë e më tepër,
Do të ndjej të ftohtë.
Por buzëqeshjen,
Do te ma shikoni në buzë,
Si përherë,
Të ngrohtë.*

41

*Dy sy të hirtë,
Më ndjekin papushim,
ndanë xhamit të kafenesë.
Dy sy të ftohtë,*

*Të shkëputur,
Jetime...*

42

*Pikojnë strehet e pallateve,
Mu në dhimbjen time.
Heq këmbët zvarrë,
Nën heshta shikimesh.*

43

*I ndjek nxënësit e mi,
Kap ngazëllimin e tyre
Prej fëmije,
Çiltërsinë e shikimeve.
Mendoj...
Bota e tyre nuk ka prapaskena.*

44

*Në parkun e harruar,
Mbi kartona mallrash,
Veç kolles torturuese,
Koka e tij,
Mbart thinjat e jetës.
Dhe rri aty tërë kohës,
Skllav e mbret i lojës.*

45

*Një mollë e kafshuar,
Hedhur në rrugë,
Ndanë trotuarit,
Më trishton së tepërmi.
Kam frikë,
Mos një ditë e tillë mbetem,
Hedhur në vetmine time.*

46

*Kjo pranverë,
Po vjen ndryshe,
Dhe sjell me vete,
Veç ngrohtësi diellore,
Çukat për mua.
E duket se më qesëndis
'Edhe sivjet,
Fytyren s'do të ta shëndris"
E sfidoj me vete.
Çukat s'janë luftëra e tërmete.*

47

*Laj
Çdo ditë pasdite,
Pas bisedimeve,
Tavlla plot funde cigaresh.
Se shtyjmë dot vrerin,
Ndaj thithim vrer.*

48

*Mundet
Që të dashurohemi,
Ti djall,
E unë engjell.
Por s'do të kishim kurrë fëmijë,*

*E di se do me harroni,
Se e vetmja sfidë,
Që i bën bukurisë,
Është jetëgjatësia.*

49

*Ajri mbrëmjes,
Përzier me erën e mirë të blirëve*

*Ndanë rrugës,
Më ndjellin një ndjesi të vakët
Pajeje e lehtësimit të harruar.
Rruga e zbrazur,
Ku dëgjohen takot në trotuar,
Shpon tej e mbanë,
Timpanet e veshëve të mi.
Pak metra më tutje,
Qeshin e piskatin,
Mbeturinat e djegura
Nga fshesaret.*

50

*Në mbeturina mbrëmjesh,
Shfrytëzoj pasqyrën për buzët
E pomaden e kuqe.
Më tej gjithçka mbetet e hedhur,
Si fundet e cigareve në tavëll.
Copëra mendimesh,
Përshkojn trurin, ndërsa unë,
Kërkoj të bëj paqe me gjumin.*

51

*Jam esull për gjithçka,
Në dhembje e gëzim.
E vetmja gjë që më deh,
E folura e paplotë
E djalit tim*

52

*Në rrugën e pafund,
Përkundem.
Mendimet më përzihen.
Shpejt e kam ndjerë veten
Vjeshtë.*

*Ndoshta askush s'do të pyese për
mua...*

Diç ka interes.

Sidoqoftë, në shpirt

Poete do të mbes.

* * *

Nga reçensionin

Krijuesja Kuksiane Vera Istrefi, pas trokitjes së suksesshme në dyert e kështjellës poetike shqipe me vëllimin poetik "Shiu i fundit" me këtë liber (të dytë me rradhë brenda një periudhe të shkurtër kohore) po hyn në botën e poezisë shqiptare me një individualitet pothuajse tërësisht të formuar. Subjekti lirik, botën shqiptare e vështron dhe e përjeton nga pikëvështrimi i femrës, e cila ndodhet në një pozitë gjithsesi më të rëndë brenda shoqërisë shqiptare të ndertuar mbi baza të forta patriarkale (veçmas në zonën e veriut) Poezia e kësaj poeteshe, në qenësinë e saj, është një dialog poetik me koordinatat e ekzistencës. Ky dialog bëhet me një ndjeshmëri të thellë dhe mjaft të sinqertë. Spektri tematik zgjerohet apo ngushtohet në varshmëri nga zgjerimi apo ngushtimi i hapësirës individuale e kolektive.

Duke qenë pjesmarrëse aktive në jetën shqiptare, në dhembjet dhe tragjeditë e saj po edhe në gezimet dhe adhurimet për gjerat e saj të shenjta, kjo poeteshë nuk është vrojtuese pasive, por përkundrazi ajo pozicionohet ndaj "objektit" të këngëtimit herë-herë deri në mallkim, e herë-herë deri në adhurim. Në të dya rastet motivimi është i plotë. Poeteshë, nëpërmjet një ligjërimi të figurshëm artistik, i qaset botës komplekse me tërë imagjinatën krijuese e përceptuese, me përjetimin e vacantë të botës fisnike e të pasur intime, me rrugën, rrjedhat dhe me peripecitë e shqetësimet që sjell kjo temë në jetë.

Poezitë e këtij vëllimi janë realizuar me tingëllimin, ritmin dhe fuqinë e ndjenjës së dashurisë, që ndihet e artikuluar me tërë bukurinë dhe me shqetësimet e saj; / Jam doruntinë zemër plasur / e vetme pranë portës / Në anën e së cilës janë engjëjt e djajtë / Pres një Konstadin / Me vete të më marrë/ ... (faqe 32).

Në vargjet e këtij libri, autorja paraqet një gjendje reale emocionale, një shqetësim të përjetuar që rrjedh mbase edhe si mesazh poetik, por që lidhet fort me jetën, me emocionin më të fuqishëm e më të sinqertë që mund të përjetohet. Poetesa depërton thellë në psikologjinë e femrës, kurse specifikat e përjetimit i jep natyrshëm me gjithë ngjyrimet komplekse që ka bota femërore, por edhe vetë dashuria.

17 mars 2001, Demir Reshiti